



6405/1
09.05.2016

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE

VLORE

Nr.1992 Regj.
Dt.Regj. 20.11.2015

Nr .156 Vendimi
Date 15.02.2016

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Sot me date 15.02.2016, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore e përbëre nga gjyqtari KEN DHIMA, asistuar prej sekretares gjyqësore Kamila Petriti, shqyrtoi ne seance gjyqësore me dyer te hapura çështjen civile me Nr. 1992 akti date 20.11.2015 qe i përket:

PADITES:

Tatimpaguesi “Brunilda Seleni”, me NIPT: L23401001V, me adrese Lagja "30 Vjetori", godine nje katshe, pranë stacionit te autobuzave tek Spitali Rajonal Berat, përfaqësuar ne gjykim nga Avokat Ardit Llangozi, me Nr.Lic: 5269, NIPT:122112013T, Anetar i Dhomës se Avokatisë Tirane, ne mungese ne shpalljen e vendimit.

TE PADITUR:

Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, me adrese: Lagja "30 Vjetori"Berat, përfaqësuar prej Znj. Silvana Sallo me Autorizimin me Nr. 39702/1Prot, date 09.12.2015,ne mungese ne shpalljen e vendimit.

Drejtoria e Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë se Përgjithshme te Tatimeve, adresa: Rr."Gjin Bue Shpata ", godina e ish maternitetit Tirane, përfaqësuar prej Znj.



Silvana Sallo me Autorizimin me Nr. 39702/1Prot, date 09.12.2015.ne mungese ne shpalljen e vendimit.

PERSON I TRETE :

Zyra Vendore te Avokatisë se Shtetit, ne mungese.

OBJEKTI:

Shfuqizimi i aktit administrativ "Njoftim-Vlerësimi" për detyrimet Nr.4369 Prot, date 14.09.2015 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat.

Shfuqizimi i vendimit Nr.28259/3 Prot, date 16.10.2015 i Drejtorisë se Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë se Përgjithshme te Tatimeve Tirane.

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative", neni 17 pika "a" për shfuqizimin tërësisht (anullimin) e aktit administrativ.Ligji Nr.9920, date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 106, 108, 109 e vijues te ligjit.

Ne përfundim te shqyrtimit gjyqësor te zhvilluar me dyer te hapura gjykata pasi dëgjoji paditësi i cili kërkoj pranimin e padisë sipas objektit dhe pasi dëgjoji te paditurin i cili kërkoj rrëzimin e padisë si te pabazuar ne prova dhe ne ligj, si dhe shqyrtoi provat e administruara ne dosje dhe bisedoi çështjen ne tërësi, si përfundim,

VEREN

Se paditësja subjekti Brunilda Seleni, i është drejtuar Gjykatës Administrative te Shkalles se Pare Vlorë me një kërkesepadi me objekt e pale te paditura si më sipër. Gjykata çmon se kjo padi është ne kompetencën funksionale te kësaj gjykate konform nenit 10/1 te Ligjit Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" ne baze te te cilit përcaktohet se : "Gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarrëveshjet

administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normativ".

Gjykata çmon se është në kompetencën lëndore të kësaj gjykate shqyrtimi i kësaj çështjeje pasi padia është një prej atyre të parashikuara në nenin 7/a të Ligjit Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" në baze të të cilit rezulton se : "a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik".

Gjithashtu gjykata çmon se është në kompetencën tokësore të kësaj gjykate shqyrtimi i kësaj çështjeje pasi sipas nenit 11/1 të Ligjit Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" në baze të të cilit rezulton se : "Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet". Akti "Njoftim-Vlerësimi" për detyrimet Nr.4369 Prot, date 14.09.2015 është nxjerre prej Drejtoria Rajonale Tatimore Berat.

Gjate shqyrtimit gjyqësor rezultoi e provuar se Subjekti Brunilda Seleni, me nr. Nipt L23401001V, është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat me aktivitet privat "Tregeti me pakice të artikujve të ndryshëm", me adrese të aktivitetit në lagjen "30 Vjetori" Berat. Subjekti i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlore me objekt padie "Shfuqizimin e akteve administrative " në lidhje me njoftim vlerësimin nr. 4369 date 14.09.2015.

Me ane të Njoftim Vlerësimit nr. 4369 date 14.09.2015 dërguar nga DRT Berat, subjektit i është komunikuar penalteti në vlerë 50.000 (pesëdhjetë mijë) leke për mosleshim të kuponit tatimor, bazuar në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 122 pika 1 germa b,i.

Pala paditëse e ka ankimuar aktin administrativ për detyrimet tatimore Njoftim Vlerësimit me nr. 4369 date 14.09.2015, në Drejtorinë e Apelit Tatimor Tirane, e cila me vendimin nr.28259/1 date 16.10.2015 (prot me DRT Berat me nr.4369/1 date 22.10.2015) ka vendosur: "Lënien në fuqi të aktit administrative Njoftim Vlerësimit për detyrimet tatimore nr. 4369 date 14.09.2015 të nxjerre nga DRT Berat".

Vlerësimi tatimor është rrjedhojë e penalizimit nga inspektorët e verifikimit në terren të DRT Berat, në baze të të cilit akt-verifikimit nr.4 date 27.07.2015 mbajtur në vendin e biznesit të subjektit Brunilda Seleni, në momentin e kryerjes së kontrollit.

Në akt-verifikimin e mbajtur në subjektin Brunilda Seleni, ndër të tjera në piken e trete të tij: pasqyrohet se : "U konstatuar se subjekti nuk lëshon kupon tatimor".

Ky akt - verifikim eshte perpiluar ne dy kopje, dhe eshte firmosur nga subjekti Brunilda Seleni dhe punonjesit verifikues.

Punonjesit me kontrat te perkoheshme pune te punesuar ne DRT Berat, ne baze te urdherit te punes me nr.3314 prot.date 27.07.2015 per kontroll ne lagjen "30 Vjetori" Berat, kane ushtruar kontroll ne subjektin Brunilda Seleni, dhe kane mbajtur akt-verifikimin nr.4 date 27.07.2015.

Ne baze akt-verifikimin nr.4 date 27.07.2015, nga ana e Drejtorise Rajonale Tatimore Berat, ka nxjerr urdhrin e punes nr.3388/2 prot.date 30.07.2015 eshte percaktuar "te ndiqen procedurat ligjore duke u bazuar ne Akt-Verifikimin e bere ne ketë subjekt nga punonjesit e Shërbimit. Nisur nga urdhri i punes nr.3314 prot.date 27.07.2015 eshte plotësuar Akt-Kostatimi dhe Procesverbali i gjobës me date 30.07.2015, me penalitetin ne vlerën 50 000 leke, për mosleshim te kuponit tatimor, bazuar ne nenin 122 pika 1 germa b pika i, e ligjit nr.9920 date 19.05.2008.

Pala paditëse pretendon se :” Ne date 27.07.2015, kam qene subjekt verifikimi nga inspektoret për dokumentacionin e ushtrimit te aktivitetit, nuk eshte konstatuar shitje te produkteve dhe per me teper nuk eshte konstatuar klient ne dyqan qe une tatimpaguesja te mos kem leshuar kupon tatimor (c'ka vertetohet nga akt-verifikimi nr.4, date 27.07.2015).

Me date 30.07.2015 nuk kam qene subjekt kontrolli (c'ka vertetohet nga akt konstatimi nr.serie 0488765 i perpiluar nga inspektoret dhe nuk nënshkruar nënshkruar nga une).

Akt-konstatimi nr.serie 0488765, date 30.07.2015 dhe Proqes-verbal gjobe nr.serie 0182471, date 30.07.2015 nuk jane marre ne vendin e ushtrimit te aktivitetit, nuk me është komunikuar dhe nuk me eshte njoftuar zyrtarisht nga DRT Berat duke me mohuar te drejtën qe sanksionohet ne Ligjin per Procedurat Tatimore ne RSH, K.Pr.Administrative, Kushtetutën e RSH dhe KEDNJ” .

Pala e paditur pretendon se paditesja ne kerkese padine e saj kerkon shfuqizimin e aktit administrative Njoftim Vleresimi per detyrimet tatimore duke pretenduar se:..."aktiviteti ka qene i mbyllur per rreth dy jave dhe ishte hapur ditën qe i kishte vajtur kontrolli rreth 30 minuta para se te kontrollohej nga punonjesit e tatimeve", pretendim i cili bie ndesh me ate qe vete subjekti ka petenduar ne kerkesen ankimore qe i eshte drejtuar Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane, ku nder te tjera shprehet se :..."Pajisja ka qene ne rregull pasi nje dite me pare ne date 26.07.2015 edhe ate dite ne date 27.07.2015 edhe nje dite me vone ka punuar dhe ka trasmetuar xhiro pra duke na treguar qe subjekti ka qene ne ushtrim te aktivitetit dhe jo si shprehet ne kerkese padi qe nuk punonte per rreth 2-jave dhe qe e hapi dyqanin ditën e kontrollit.

Ne lidhje me sa pretendon paditesja qe nuk eshte konstatuar shitje te produkteve dhe per me teper nuk eshte konstatuar klient ne dyqan, c'ka vertetohet ne akt-verifikimin nr.4 date 27.07.2015, bejme me dije gjykatën se: Ne aktin e Verifikimit ku dhe vete

tatimpaguesja(paditesja) ka firmosur eshte e shprehur saktesisht ne piken e trete te aktit se : U konstatua nuk leshon kupon tatimor" Prej kesaj pale u preteindua se pala paditese ka qene dakord per aq kohe sa ka firmosur akt verifikimin e dates 27.07.2015.

Pala e paditur pretendon se me daten 30.07.2015 ne subjektin e paditeses nuk eshte ushtruar kontroll nga DRT Berat, por ashtu si dhe eshte permendur edhe me siper, akt kostatimi dhe procesverbalii gjobesi dates 30.07.2015, jane mbajtur ne baze te urdhrimit te punes nr.3388/2 prot.date 30.07.2015, ku kerkohet te ndiqen proceduart ligjore ne baze te akt verifikimit te bere ne kete subjekt nga punonjesit e sherbimit.

Ne aktin e kostatimit nr.0488765 date 30.07.2015 nuk eshte shprehur se eshte ushtruar kontroll ne subjektin Brunilda Seleni, por shprehet se:...per kthim pergjigje te akt-verifikimit nr.4 date 27.07.2015 i mbajtur nga punonjesit me kontrat teperkohshemte DRT Berat...te cilet kane kryer kontroll te subjekti Brunilda Seleni me aktivitet tregeti te artikujve te ndryshem, kane konstatuar se subjekti nuk leshon kupon tatimor..."

Ne akt-verifikimin e mbajtur ne subjektin Brunilda Seleni, nder te tjera ne piken e trete te tij: pasqyrohet se : "*U konstatua se subjekti nuk leshon kupon tatimor*". Ky akt - verifikim eshte perpiluar ne dy kopje, dhe eshte firmosur nga subjekti Brunilda Seleni dhe punonjesit verifikues.

Gjykata konstaton se prej palës se paditur D.R.Tatimore Berat është mbajtur Akt-Konstatimi dhe Procesverbali i gjobës me date 30.07.2015, me penalitetin ne vlerën 50 000 leke, për mosleshim te kuponit tatimor, bazuar ne nenin 122 pika 1 germa b pika i, e ligjit nr.9920 date 19.05.2008.

Akt-Kostatimi i mbajtur me date 30.07.2015, nuk rezulton te jete nënshkruar prej tatimpaguesit, rubrika per tatimpaguesin rezulton te jete plotësuar me te njëjtin shkrim si dhe përmbajtja e vete akt konstatimit, si dhe shoqeruar me shenimin "*Bashkengjitur eshte akt verifikimi Nr.4*" Ky akt nuk eshte nënshkruar rregullisht prej tatimpaguesit si ligji përcakton, gjithashtu nuk rezultoi qe ky akt ti jete njoftuar rregullisht tatimpaguesit.

Procesverbali i gjobes me date 30.07.2015, nuk rezulton te jete nënshkruar prej tatimpaguesit, rubrika per tatimpaguesin rezulton te jete plotësuar me te njëjtin shkrim si dhe përmbajtja e vete aktit procesverbal gjobe nr. 0182471, si dhe shoqeruar me shenimin "*Bashkngjitur eshte akt verifikimi Nr.4 si dhe akt konstatimi 0488765*" Ky akte nuk eshte nënshkruar rregullisht prej tatimpaguesit si ligji përcakton, gjithashtu nuk rezultoj qe ky akt ti jete njoftuar rregullisht tatimpaguesit.

Ne momentin verifikimit te subjektit Brunilda Seleni prej inspektoreve te DRT Berat nuk eshte konstatuar shitje te produkteve dhe per me teper nuk eshte konstatuar se ishte kliente ne dyqan. Edhe pse pajisja fiskale ne momentin e ushtrimit te kontrollit prej inspektoreve nuk ka rezultuar e ndezur kjo nuk provon fakti se subjekti nuk leshon kupon tatimore gjate ushtrimit te aktivitetit. Nuk rezulton e provuar qe gjate

ushtrimit te aktivitetit Subekti "Brunilda Seleni" te mos kete leshuar kupon tatimor. Akt verifikimi Nr. 4 i dates 27.07.2015 , përbenë një akt ne te cilin nuk pasqyrohet realiteti objektiv persa i perkte pikës se trete : *"U konstatua se nuk lëshon kupon tatimor"*.

Për sa i përket akteve administrative Akt-Kostatimi i mbajtur ne daten 30.07.2015 si dhe Procesverbalit te gjobës i mbajtur ne daten 30.07.2015 , prej gjykates vlerësohet se përbejnë akte te mbajtura jo ne përputhje me ligjin dhe duke mos respektuar procedurën për nxjerrjen e këtyre akteve.

Akt verifikimi Nr. 4 i datës 27.07.2015, Akt-Kostatimi i mbajtur me date 30.07.2015, Procesverbali i gjobës me date 30.07.2015, vlerësohen prej gjykates si akte te pavlefshëm . Duke qene se "Njoftim-Vlerësimi" per detyrimet Nr.4369 Prot, date 14.09.2015 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, ka pas si baze akte e sipërpërmendur te konsideruar si akte te pavlefshme, atëherë gjykata vlerëson se akti "Njoftim-Vlerësimi" për detyrimet Nr.4369 Prot, date 14.09.2015 duhet te shfuqizohet. Me te njëjtin arsyetim gjykata vlerëson se duhet te shfuqizohet edhe Vendimi Nr.28259/3 Prot, date 16.10.2015 i Drejtorise se Apelimit Tatimor.

Per sa me sipër gjykata vlerëson se kerkesepadia është e bazuar ne prova dhe ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

Për Këto Arsye:

Gjykata, ne baze te Ligjit Nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative", neni 17 pika "a" per shfuqizimin teresisht (anullimin) e aktit administrativ;Ligji Nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, nenet 106, 108, 109 e vijues te ligjit.

VENDOSI:

1. Pranimin e kerkesepadisë si te bazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Shfuqizimin e aktit administrativ "Njoftim-Vlerësimi" për detyrimet Nr.4369 Prot, date 14.09.2015 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat per gjoben ne masen 50.000(pesedhjte) mije leke.
3. Shfuqizimin e vendimit Nr.28259/3 Prot, date 16.10.2015 te Drejtorisë se Apelimit Tatimor Tirane.

4. Shpenzimet gjyqësore ne ngarkim te palës se paditur.
5. Ndaj ketij vendimi nukleshohet urdher ekzekutimi.
6. Urdherohet zyra e permbarimit me ekzekutimin e ketij vendimi.
7. Ky vendim eshte i formes se prere dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Vlorë, sot më dt. 15.02.2016.

SEKRETARE

KAMILA PETRITI



GJYQ TAR

KEN DHIMA

